



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2021

PËR

MBËSHETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-EVE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e *startup*-eve dhe mbështetjen e ekosistemit, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton organet shtetërore kompetente dhe procedurat që zbatohen për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve dhe të ekosistemit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “**Ekosistem**”, bashkëveprimi i individëve, *startup*-eve, si dhe organizatave të tjera që veprojnë si lehtësues, të cilët bashkërisht veprojnë si inkubator për krijimin e rritjen e *startup*-eve;
- b) “**Inkubim**”, procesi i mbështetjes, përgatitjes, transformimit të idesë në model biznesi dhe i zhvillimit të një *startup*-i inovativ, në fazën fillestare të tij;
- c) “**Lehtësues të *startup*-eve**”, aktorët e ndryshëm të ekosistemit që ofrojnë programe dhe shërbime mbështetëse për *startup*-et, përfshirë, por pa u kufizuar në: inkubatorë, përsheptues, ofrues ambientesh dhe pajisjesh pune, mentorues, këshillues, trajnues, ofrues asistence përgjatë zhvillimit të biznesit, qendra teknologjike dhe inovacioni, organizatorë eventesh, institucione të arsimit të lartë, organizata kërkimore, ofrues të shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare apo të biznesit;
- ç) “**Nomadët digjitalë**”, shtetasit e huaj që punojnë nëpërmjet teknologjisë së informacionit në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të institucionit dhe puna e tyre kryesisht është puna lëvizëse, të cilët përfitojnë statusin e përfitimet e “punonjësit lëvizës digjital”, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;
- d) “**Startup**”, personi juridik ose persona fizikë, të vetëm dhe të bashkuar, të cilët konceptojnë dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi të ri dhe të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.

Neni 4

Parimet e mbështetjes së *startup*-eve

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) Lehtësimi në krijimin, hyrjen në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së *startup*-eve;
- b) Tërheqja dhe mbajtja e talentit dhe e burimeve njerëzore;
- c) Inovacioni në kuadrin rregullator e në procedurat e prokurimit;
- ç) Lehtësimi dhe mbështetja në aksesimin e burimeve financiare;
- d) Përfshirja sociale dhe diversiteti në mbrojtje të vlerave demokratike.

Neni 5

Format e mbështetjes së *startup*-eve

Mbështetja për zhvillimin e *startup*-eve kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimit “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e *startup*-eve;
- b) zhvillimit të ekosistemit mbështetës për *startup*-et;

- c) dhënies së granteve financiare ose masave mbështetëse për zhvillimin e *startup*-eve;
- ç) formave të tjera mbështetëse të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta.

Neni 6

Organet përgjegjëse

Organet përgjegjëse në fushën e nxitjes, ndihmës dhe zhvillimit të *startup*-eve, sipas këtij ligji, janë:

- a) ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- b) Këshilli i *Startup*-eve;
- c) ministritë ose institucionet e tjera publike.

Neni 7

Detyrat e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe struktura përgjegjëse e tij ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Zhvillon politikën shtetërore në fushën e mbështetjes së *startup*-eve;
- b) Koordinon zbatimin e politikave të zhvillimit të *startup*-eve në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të sipërmarrjes në vend;
- c) Bashkërendon me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- ç) Merr pjesë në menaxhimin e miratimit të fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së *startup*-eve, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për menaxhimin buxhetor;
- d) Miraton modelet tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që nënshkruhen ndërmjet ministrisë, *startup*-eve dhe lehtësuesve;
- dh) Miraton thirrjet për grante financiare ose masa mbështetëse, përfshirë formën dhe sasinë e granteve financiare ose formën e masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e *startup*-eve;
- e) Miraton rregullat e procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të *startup*-eve;
- ë) Administron regjistrin e *startup*-eve dhe të lehtësuesve, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- f) Administron faqen zyrtare në internet të institucionit dhe “*Startup Albania*”, me qëllim informimin e ndërgjegjësimin e publikut, si dhe ofron shërbimin “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e *startup*-eve;
- g) Mbështet zhvillimin e ekosistemit mbështetës për *startup*-et nëpërmjet mbështetjes së veprimtarisë së *startup*-eve dhe të lehtësuesve;

- gj) Mbështet administrativisht Këshillin e *Startup-eve*;
- h) Merr në dorëzim kërkesat e paraqitura nga *startup-et* dhe kryen procedurat e vlerësimit sipas këtij ligji;
- i) Lidh e monitoron zbatimin e marrëveshjeve me *startup-et* që përfitojnë grantet financiare, programet dhe masat mbështetëse sipas këtij ligji;
- j) Vepron si organ mbështetës për *startup-et*, duke bërë të mundur tërheqjen dhe duke mbështetur alokimin e fondeve ose të granteve të donatorëve të huaj për *startup-et* dhe inovacionin në Shqipëri;
- k) Bashkëpunon me institucionet vendase dhe organizata ndërkombëtare dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në rritjen e ndërgjegjësimit publik për fushën dhe veprimtarinë e *startup-eve*, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ky ligj;
- l) Të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 8

Këshilli i *Startup-eve*

1. Këshilli i *Startup-eve* (në vijim, Këshilli) ngrihet pranë ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe jep kontribut në nxitjen e zhvillimit të *startup-eve* si organ kolegjal që vepron në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike.
2. Kryetar i Këshillit është ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
3. Kabineti i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes vepron si sekretariat teknik i Këshillit dhe e mbështet atë për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky ligj.
4. Rregulla të hollësishme për përbërjen e Këshillit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit, kompetencat, organizimin e funksionimin e Këshillit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Detyrat e ministrive ose të institucioneve të tjera publike

Ministritë ose institucionet e tjera publike, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të tyre, kanë përgjegjësitë dhe kryejnë detyrat e mëposhtme:

- a) Asistojnë procesin e mbështetjes dhe të zhvillimit të *startup-eve*, në përputhje me parimin pa letër dhe tarifa zero në marrjen e shërbimeve. Shërbimet për të

cilat, në kuadër të këtij ligji, aplikohet tarifa zero, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

- b) Japin mendim të arsyetuar për përputhjen ligjore midis idesë së biznesit të *startup*-it kërkues për grante ose masa mbështetëse dhe fushën e tyre të aktivitetit;
- c) Kryejnë të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

KREU II

MBËSHTETJA E *STARTUP*-EVE

Neni 10

***Startup*-et**

1. Personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital, merr statusin si *startup* në momentin e plotësimit të një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe lehtësuesve.
2. Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit dhe e statusit si *startup* është 24 (njëzet e katër) muaj nga momenti i plotësimit të vetëdeklarimit në regjistrin e *startup*-eve.
3. Regjistrimi dhe marrëdhënia e *startup*-eve dhe lehtësuesve me ekosistemin dhe skemën e mbështetjes së *startup*-eve dhe lehtësuesve kryhet duke u bazuar në parimet pa letër dhe tarifa zero në marrjen e shërbimeve.

Neni 11

Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve

1. Regjistri i *startup*-eve dhe lehtësuesve (në vijim, regjistri) krijohet e administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si bazë shtetërore të dhënash në funksion të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.
2. Regjistri shërben për vetëdeklarimin e *startup*-eve dhe për mbajtjen e të dhënave të *startup*-eve dhe të lehtësuesve të regjistruar, për kërkuesit dhe përfituesit e granteve dhe të masave të tjera mbështetëse nga ana e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
3. Në momentin e vetëdeklarimit të *startup*-it, nëpërmjet regjistrit të *startup*-eve, automatikisht gjenerohet numri unik i identifikimit dhe dokumenti elektronik - pasaporta e *startup*-eve.

4. Lehtësuesit të *startup*-eve, në momentin e regjistrimit në regjistër sipas këtij ligji, i gjenerohet automatikisht numri unik i identifikimit dhe dokumenti elektronik - pasaporta e lehtësuesve.
5. Rregulla të hollësishme për përmbajtjen e regjistrimit, mënyrën e funksionimit të regjistrimit dhe ndërlidhjen e tij me portalin *e-Albania*, si dhe për dokumentet elektronike - pasaporta e *startup*-eve dhe pasaporta e lehtësuesve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Mbështetja e *startup*-eve nëpërmjet shërbimit *startup one-stop-shop*

1. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe struktura përgjegjëse e tij, me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe të rritjes të *startup*-eve, ofron shërbimin *startup one-stop-shop*.
2. Shërbimi *startup one-stop-shop* mund të ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe në të përfshihen:
 - a) dhënia e informacioneve për kuadrin ligjor rregullator, përfshirë, por pa u kufizuar mbi detyrimet lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit, mbi detyrimet fiskale e tatimore pas periudhës 24-mujore të inkubimit;
 - b) dhënia e këshillimit për dokumentet e nevojshme për regjistrimin në regjistrin tregtar, nëse është e nevojshme, për regjistrimin e patentave, markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale dhe të pronësisë intelektuale, pas periudhës 24-mujore të inkubimit;
 - c) dhënia e këshillimit për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të të drejtave civile dhe tregtare;
 - ç) organizimi i eventeve informuese dhe i aktiviteteve njohëse ndërmjet *startup*-eve të interesuara;
 - d) dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të *startup*-eve.
3. Rregullat e hollësishme për veprimtarinë dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit *startup one-stop-shop* përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Mbështetja e *startup*-eve nëpërmjet ekosistemit

1. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe struktura përgjegjëse e tij sigurohet për të asistuar e bashkërenduar veprimtarinë e ekosistemit mbështetës për *startup*-et dhe suportin e *startup*-eve dhe lehtësuesve të

përfshirë në ekosistem, në bashkëpunim me Këshillin. Mënyra e bashkërendimit dhe e asistimit në veprimtarinë e ekosistemit, parashikuar në këtë pikë, do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Personi fizik ose juridik, që ka fushë kryesore të veprimtarisë trajnimit ose mbështetjen në fushën e inovacionit, të teknologjisë ose në fusha të ngjashme me to, merr statusin e lehtësuesit të *startup*-eve, duke u regjistruar në regjistrin e *startup*-eve.
3. Krite të hollësishme për kapacitetet njerëzore, administrative dhe infrastrukturore të lehtësuesve të *startup*-eve, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Mbështetja e *startup*-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse

1. *Startup*-et e regjistruara në regjistër përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera, sipas legjislacionit në fuqi, pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.
2. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes shpall thirrjen për kërkesë nga ana e *startup*-eve nëpërmjet publikimit në *startup one stop-shop*, në faqen zyrtare, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
3. Thirrja për kërkesë për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kriteret, procedurat dhe afatet, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh kushtet e përgjithshme, si më poshtë vijon:
 - a) Mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
 - b) Mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
 - c) Fuqizimi i grave sipërmarrëse;
 - ç) Fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
 - d) Prioritete të tjera, sipas urdhrit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
4. Kryetar i Komisionit është ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Rregulla të hollësishme për përbërjen e Komisionit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. *Startup*-et kërkuese shpallen fituese me vendim të komisionit vlerësues vetëm nëse plotësojnë kriteret e pikës 3, të këtij neni.

6. Vendimi për dhënien e grantit zbatohet nga njësia përgjegjëse, sipas ligjit në fuqi për buxhetin e shtetit, me kërkesë të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
7. Vendimi i komisionit vlerësues për përfituesit e granteve financiare për mbështetjen e *startup*-eve, sipas thirrjes, botohet në faqen zyrtare të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
8. Ndaj vendimit të komisionit mund të bëhet ankimi, në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 15 **Monitorimi i masave mbështetëse**

1. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe struktura përgjegjëse e tij, gjatë periudhës së inkubimit dhe periudhës së regjistrimit si *startup* ose si lehtësues i *startup*-eve, monitoron periodikisht *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të këtij ligji.
2. *Startup*-et dhe lehtësuesit kanë detyrimin e raportimit dhe të vënies në dispozicion të dokumenteve të kërkuara nga ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe struktura përgjegjëse e tij brenda një afati konkret.
3. Rregulla të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për t'u paraqitur nga *startup*-et ose lehtësuesit përcaktohen në urdhrin përkatës të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

KREU III **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 16 **Aktet nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, 9, 11 pika 5, 12, pika 3, 13 pikat 1 dhe 3, dhe 14, pikat 3 dhe 4, të këtij ligji, dhe ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim të pikës 3, të nenit 15, të këtij ligji, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA